

Përmbledhje

- **Në TM4 2024, ekonomia e Eurozonës shënoi rritje reale ekonomike prej 0.2 përqind, një ngadalësim i trendit të rritjes kundrejt tremujorit paraprak, ndërkohë që rritja vjetore rezultoi 1.2 përqind, mbështetur nga konsumi dhe investimet.** Pavarësisht ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në këtë periudhë, parashikimet e BQE-së sugjerojnë se ekonomia do të vazhdojë të rritet, me rritje prej 0.9 përqind në vitin 2025 dhe 1.2 përqind në 2026. Njëkohësisht, inflacioni në Eurozonë shënoi rritje prej 2.2 përqind në TM4 2024, kryesisht për shkak të çmimeve të larta të shërbimeve dhe energjisë. Megjithatë, pritjet e BQE-së sugjerojnë se inflacioni do të ngadalësohet në 2.3 përqind në vitin 2025 dhe 1.9 përqind në 2026, ndërkohë që perspektiva mbetet e pasigurt për shkak të rreziqeve gjeopolitike dhe luhatjeve të mundshme në tregjet globale të mallrave, të cilat mund të ndikojnë në dinamikën e inflacionit.
- **Ekonomia e Kosovës shënoi rritje prej 4.4 përqind në vitin 2024, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe investimeve, ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht në aktivitetin ekonomik. Në TM4 2024, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 4.1 përqind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.** Rritja është nxitur kryesisht nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksportit. Në anën tjetër, importet e mallrave dhe shërbimeve ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik, dinamikë që rezultoi nga rritja e kërkesës vendore dhe liberalizimi i vizave. Rritja e aktivitetit ekonomik është mbështetur nga industria përpunuese, tregtia dhe ndërtimtaria.
- **Inflacioni në TM4 2024 ra në 0.7 përqind, nga 1.3 përqind në tremujorin paraprak.** Rënia e çmimeve të energjisë dhe dinamikat lehtësuese në çmimet e mallrave tjera dhe shërbimeve diktuan ecurinë rënëse të inflacionit. Në anën tjetër, rritja e përshpejtuar e çmimeve të ushqimit rezultoi nxitësi kryesor i inflacionit në TM4 2024. Ecuria rënëse e çmimeve u pasqyrua edhe në inflacionin bazë që u ngadalësua në 2.2 përqind nga 3.3 përqind në tremujorin paraprak. Indeksi i çmimeve të importit shënoi rritje të ngadalësuar, ndërsa u evidentua rritje e presioneve inflacioniste në koston e prodhimit të brendshëm.
- **Në TM4 2024, të hyrat primare buxhetore arritën vlerën neto 823.4 milionë euro, duke shënuar rritje prej 11.6 përqind. Shpenzimet primare u rritën për 7.0 përqind, duke arritur në 1.1 miliardë euro. Si rezultat i nivelit më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat, Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 289.3 milionë euro.** Të hyrat tatimore shënuan rritje prej 11.1 përqind, me tatimet direkte që u rritën për 10.7 përqind, ndërsa tatimet indirekte u rritën për 10.1 përqind. Ndërkohë, të hyrat jo-tatimore shënuan rritje të konsiderueshme prej 16.8 përqind, të cilat kanë një pjesëmarrje më të vogël në gjithsej të hyrat buxhetore. Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 5.5 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale shënuan rritje më të lartë prej 10.8 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar.
- **Deficiti i llogarisë rrjedhëse shënoi rritje vjetore prej 18.3 përqind në TM4 2024 dhe arriti në 488.0 milionë euro, kryesisht për shkak të përkeqësimit të bilancit tregtar dhe rënies së të ardhurave dytësore.** Megjithatë, sektori i shërbimeve dhe të ardhurat parësore patën ndikim pozitiv, duke siguruar burim të qëndrueshëm të të hyrave financiare. Remitentat në këtë tremujor arritën në 344.2 milionë euro, me rritje të ngadalësuar prej 3.0 përqind. Ndërsa, investimet e huaja direkte shënuan rënie prej 17.1 përqind, duke rënë në 183.4 milionë euro, megjithëse sektori i patundshmërisë vazhdoi të tërheqë kapital të konsiderueshëm.
- **Sektori bankar** ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar të aseteve, ndikuar kryesisht nga zgjerimi i shpejtë i aktivitetit kreditues. Në tremujorin e fundit të vitit 2024, kreditë për segmentin e ekonomive familjare dhe atë të korporatave jo-financiare u karakterizuan nga një ritëm i shpejtë rritjeje. Kjo dinamikë ishte rezultat i zgjerimit të kredive konsumuese dhe atyre hipotekare në kuadër të ekonomive familjare, ndërsa zgjerimi i kredive të KJF-ve u ndikua kryesisht nga rritja e theksuar e kredive investive. Po ashtu, depozitat, që përbëjnë burimin kryesor të financimit për aktivitetin kreditues, kanë shënuar rritje më të lartë krahasuar me vitin e kaluar. Fitimi i sektorit ka pasur rritje të përshpejtuar, rezultat ky i rritjes më të lartë të të hyrave në raport me rritjen më të ngadalësuar të shpenzimeve. Pozicioni i kapitalit u përforcua tutje nga tremujori paraprak, mirëpo në krahasim me vitin paraprak treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka shënuar rënie të lehtë si rezultat i rritjes më të lartë të mjeteve të peshuara me rrezik. Po ashtu, treguesit e likuiditetit dhe financimit shënuan trend rënës, por mbeten lartë mbi nivelet minimale rregullatore.
- **Sektori pensional** - vazhdoi rritjen e përshpejtuar vjetore të aseteve, kryesisht si rezultat i rritjes së konsiderueshme të kthimit bruto në investime në tregun ndërkombëtar, ndërsa në një masë më të vogël, nga rritja e kontributeve të reja. Po ashtu, çmimi i aksioneve u rrit krahasuar me vitin paraprak.
- **Sektori i sigurimeve** - shënoi rritje të mëtejshme të aseteve, megjithëse me një ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar. Përmirësimi i fitimit neto të sektorit u ndikua nga rritja e të hyrave, veçanërisht nga primet neto të sigurimeve jo-jetë, si dhe nga ritmi i ngadalësuar i rritjes së shpenzimeve dhe dëmeve të ndodhura.
- **Sektori mikrofinanciar** - vazhdoi rritjen e lartë të ndikuar kryesisht nga rritja e kreditimit, megjithëse me një dinamikë më të ngadalësuar në krahasim me vitin paraprak. Po ashtu, huamarrjet nga sektori i jashtëm, që përbëjnë burimin kryesor të financimit, shënuan ngadalësim të trendit rritës. Profiti i sektorit shënoi përshpejtim të rritjes, si rezultat rritjes më të lartë të vlerës së të hyrave krahasuar me shpenzimet. Cilësia e portofolit kreditor mbeti e qëndrueshme, me nivele të ulëta të kredive jo-performuese.

**Lista e shkurtesave**

|       |                                                                       |
|-------|-----------------------------------------------------------------------|
| ASK   | Agjencia e Statistikave të Kosovës                                    |
| BPV   | Bruto Produkti Vendor                                                 |
| BQE   | Banka Qendrore Evropiane                                              |
| BQK   | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës                                |
| EUR   | Valuta Euro                                                           |
| FAO   | Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi) |
| FMN   | Fondi Monetar Ndërkombëtar                                            |
| IÇIMP | Indeksi i Çmimit të Importit                                          |
| IÇK   | Indeksi i Çmimeve të Konsumit                                         |
| IHD   | Investimet e Huaja Direkte                                            |
| KJF   | Korporatat jo-financiare                                              |
| MFPT  | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës  |
| MMBTU | Metric Million British Thermal Unit                                   |
| WEO   | World Economic Outlook                                                |

Përmbajtja

Përmbledhje ..... i

1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor ..... 3

2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare ..... 4

3. Ekonomia e Kosovës ..... 6

    3.1. Rritja Ekonomike ..... 6

    3.2. Çmimet ..... 7

    3.3. Sektori Fiskal..... 9

    3.4. Sektori i jashtëm..... 11

4. Sistemi financiar ..... 15

    4.1. Sektori bankar ..... 15

    4.2. Sektori pensional ..... 24

    4.3. Sektori i sigurimeve..... 26

    4.4. Sektori mikrofinanciar..... 28

    4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës..... 31

## 1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

**Ekonomia e Eurozonës shënoi rritje modeste në TM4 2024. Sipas të dhënave nga Eurostat, BPV-ja në Eurozonë u rrit me vetëm 0.2 përqind kundrejt tremujorit paraprak, ngadalësim i dukshëm krahasuar me tremujorin paraprak, ku rritja ishte 0.4 përqind.** Në terma vjetorë, aktiviteti ekonomik në Eurozonë shënoi rritje prej 1.2 përqind, nivel i qëndrueshëm, pavarësisht ndikimit të politikave monetare të BQE-së dhe pasigurisë ekonomike globale. Rritja ekonomike u mbështet nga konsumi privat (0.2 pikë përqindje), konsumi publik (0.1 pikë përqindje) dhe formimi i bruto kapitalit (0.1 pikë përqindje), ndërsa ndryshimi në inventar kishte ndikim negativ (-0.2 pikë përqindje). Eksporti neto pati kontribut neutral në rritje (0.0 pikë përqindje).

Disa nga ekonomitë kryesore të Eurozonës treguan rezultate të ndryshme, duke reflektuar ndikimin e normave ende të larta të interesit, inflacionit dhe luhatjeve të kërkesës globale. Ekonomia e Gjermanisë u tkurr me -0.2 përqind në TM4 2024 krahasuar me tremujorin e mëparshëm, e ndikuar kryesisht nga rënia e eksporteve, ndërkohë që konsumi final privat dhe konsumi i publik regjistruan rritje. Franca, ekonomia e dytë më e madhe e Eurozonës, regjistroi rënie të lehtë prej -0.1 përqind, e ndikuar kryesisht nga përfundimi i efektit të lojërave olimpike. Ndryshe nga vendet tjera, Spanja arriti të ruajë rritjen e aktivitet ekonomik prej 0.8 përqind. **Ekonomia e Eurozonës pritet të vazhdojë me rritje të kujdesshme. Parashikimet nga BQE-ja për vitin 2025 sugjerojnë rritje prej 0.9 përqind, ndërsa për vitin 2026 pritet një zgjerim i mëtejshëm deri në 1.2 përqind.** Këto projeksione varen nga disa faktorë kyç, si politika monetare e BQE-së, që synon të balancojë inflacionin dhe rritjen ekonomike, por edhe nga stabiliteti i zinxhirëve të furnizimit dhe marrëdhënieve tregtare globale. Pavarësisht stabilizimit të inflacionit dhe mundësisë që BQE-ja të ndërmarrë masa lehtësuese në politikën monetare, sfidat strukturore dhe tensionet gjeopolitike mund të ndikojnë në perspektivën e rritjes ekonomike.

**Inflacioni në Eurozonë shfaqti tendencë të lehtë të rritjes në dhjetor, duke arritur në 2.4 përqind.** Kjo rritje u ndikua kryesisht nga çmimet e larta të shërbimeve dhe pjesërisht nga çmimet e energjisë. Inflacioni në sektorin e shërbimeve arriti në 4.0 përqind në dhjetor. Ndërsa çmimet e energjisë, të cilat në pjesën e parë të vitit kishin ndikuar në ngadalësimin e inflacionit, shënuan rritje të lehtë. Çmimet e ushqimeve, alkoolit dhe duhanit mbetën të qëndrueshme në 2.6 përqind. **Projeksionet e BQE-së sugjerojnë ngadalësim të inflacionit në 2.3 përqind për 2025 dhe 1.9 përqind për vitin 2026,** megjithatë pasiguritë gjeopolitike dhe luhatjet e mundshme të çmimeve në tregjet globale mund të ndikojnë në dinamikën e inflacionit. Në prill 2025, BQE-ja uli për herë të shtatë radhazi normat e interesit, duke vazhduar politikën monetare lehtësuese që nisi në qershor 2024. Norma e depozitave u ul në 2.25 përqind, ndërsa norma për operacionet e ri-financimit në 2.40 përqind dhe norma e huadhënies në 2.65 përqind.

**Projeksionet e FMN-së sugjerojnë se rajoni i Ballkanit Perëndimor pritet të shënojë rritje mesatare ekonomike prej 3.2 përqind në vitin 2024 dhe 3.6 përqind në vitin 2025.** Megjithatë, vendet e rajonit vazhdojnë të përballen me sfida të rëndësishme, si normat ende të larta të interesit dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë. Sa i përket inflacionit, shkalla mesatare për tremujorin e fundit të vitit 2024 ishte 2.5 përqind, duke treguar tendencë të moderuar për mbajtjen e inflacionit nën kontroll. Megjithatë, ndonëse inflacioni është më i ulët në disa vende, dallimet midis shteteve të rajonit mbeten të theksuara. Serbia regjistroi shkallën më të lartë të inflacionit (4.4 përqind), ndërsa Kosova kishte normën më të ulët (0.7 përqind).


Në TM4 2024, dinamika e këmbimit valutor të euros ka treguar ndryshime të dukshme kundrejt valutave të partnerëve tregtarë. Vlera e euros mbeti e qëndrueshme ndaj denarit maqedonas dhe lirës turke në krahasim me tremujorin paraprak, ndërsa u zhvlerësua kundrejt valutave të tjera, përfshirë dollarin amerikan, frangun zviceran, lekun shqiptar dhe sterlinën britanike.

## 2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Në TM4 2024, indeksi i çmimeve të mallrave bazë, sipas Bankës Botërore, vijoi tendencën rënëse, duke shënuar rënie vjetore prej 4.2 përqind dhe duke përmbyllur vitin me rënie prej 2.7 përqind. Kjo u diktua kryesisht nga rënia e çmimeve të naftës, e cila reflektoi përmirësime në ofertë. Megjithatë, presione inflacioniste u evidentuan në çmimet e gazit natyror dhe ushqimit, të cilat u ndikuan nga kërkesa dhe kushtet klimatike. Po ashtu, çmimet e metaleve bazë shënuan rritje, nxitur nga politikat stimuluese në Kinë, si dhe çmimet e metaleve të çmuara, që reflektuan tensione gjeopolitike dhe pasiguri makroekonomike.


Çmimet e naftës së papërpunuar Brent ranë në \$74.6/fuçi në TM4 2024, duke shënuar rënie vjetore prej 11.2 përqind dhe duke përmbyllur vitin 2024 me rënie prej 2.3 përqind (grafik 1). Në fillim të tremujorit, tensionet gjeopolitike në Lindjen e Mesme shkaktuan rritjen e çmimit në mbi \$80/fuçi. Megjithatë, oferta e qëndrueshme dhe rritja e ngadalësuar e kërkesës ushtruan presion në kahun rënës duke bërë që çmimet t'i rikthehen ecures rënëse. Parashikimet për vitin 2025 sugjerojnë stabilizim të çmimeve në rreth \$72/fuçi, të mbështetur kryesisht nga zgjerimi i ofertës globale. Megjithatë, çmimet e naftës mbeten të ndjeshme ndaj faktorëve makroekonomikë dhe zhvillimeve gjeopolitike, me rreziqe të lidhura me vendimet e OPEC+ për politikën e reduktimeve të prodhimit, ecurinë e kërkesës globale dhe tensionet gjeopolitike.

Grafik 1. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Çmimet e gazit natyror në Evropë u rritën në \$13.6/mmbtu, duke shënuar rritje vjetore prej 0.3 përqind kundrejt një baze më të lartë në TM4 2023, por një rritje prej 18.0 përqind krahasuar me tremujorin paraprak (grafik 1). Rritja u shkaktua nga intensifikimi i konkurrencës globale për eksportet e LNG-së, pasiguritë për furnizim me gaz nga Rusia, dhe kërkesa e lartë sezonale e cila përshpejtoi tkurrjen e rezervave përtej pritshmërive. Megjithatë, në terma vjetorë, çmimet e gazit natyror në Evropë ranë për 16.4 përqind në 2024. Parashikimet për vitin 2025 sugjerojnë rritje prej 6.5 përqind, me rreziqe të lidhura kryesisht me kërkesën globale, konkurrencën për LNG dhe faktorët gjeopolitikë që mund të ndikojnë furnizimin me gaz nga Rusia.

Grafik 2. Indeksi i metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara




Çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rritje vjetore prej 7.2 përqind në TM4 2024, duke përmbyllur vitin me rritje prej 2.6 përqind (grafik 2). Rritja vjetore e indeksit të metaleve bazë, prej 12.9 përqind, u nxit nga pritshmëritë për rritje të kërkesës në Kinë si rrjedhojë e politikave stimuluese. Megjithatë, efikasiteti i ulët i këtyre politikave, oferta e qëndrueshme dhe ngadalësimi i aktivitetit industrial në ekonominë e mëdha ndikuan që çmimet t'i rikthehen tendencës së tyre rënëse. Çmimet e xehes së hekurit, nikelit dhe plumbit pësuan rënie, ndërsa metaleve të tjera shënuan rritje për shkak të kërkesës së qëndrueshme nga proceset e tranzicionit energjetik. Parashikimet për vitin 2025

sugjerojnë një rritje modeste prej 0.8 përqind të çmimeve të metaleve bazë, e kufizuar kryesisht nga rritja e dobët e aktivitetit industrial.

Në anën tjetër, çmimet e metaleve të çmuara shënuan rritje vjetore prej 34.5 përqind, të udhëhequra nga çmimi i arit me rritje prej 34.8 përqind dhe i argjendit me 35.2 përqind. Çmimi i arit arriti një nivel të lartë historik në tetor, mbështetur nga kërkesa e lartë si pasojë e tensioneve gjeopolitike. Për vitin 2025, parashikohet që çmimet e metaleve të çmuara të mbeten të larta, me çmimin e arit të mbështetur nga tensionet gjeopolitike dhe pasiguritë makroekonomike, ndërsa çmimet e argjendit pritet të rriten për shkak të ofertës së kufizuar dhe kërkesës së qëndrueshme, veçanërisht nga sektori i energjisë së ripërtëritshme.

Sipas indeksit të FAOs, çmimet e ushqimit shënuan rritje nominale vjetore prej 6.0 përqind në TM4 2024 (grafik 3). Megjithatë, në terma vjetorë, ato rezultuan 2.0 përqind më të ulëta krahasuar me vitin 2023. Rritje më e theksuar u regjistrua në çmimet e vajrave, e nxitur nga pasiguritë mbi ofertën si pasojë e kushteve jo të favorshme klimatike. Çmimet e bulmetit u mbështetën kryesisht nga kërkesa e qëndrueshme kundrejt ofertës më të kufizuar. Rritja vjetore e çmimeve të mishit reflektoi një efekt baze. Nga ana tjetër, kërkesa e moderuar kundrejt një oferte relativisht të qëndrueshme të drithërave, së bashku me përmirësimin e kushteve klimatike në vendet kryesore eksportuese të sheqerit, ushtruan presione në kahun rënës të çmimeve për këto kategori.

Grafik 3. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Burimi: FAO.

## 3. Ekonomia e Kosovës

### 3.1. Rritja Ekonomike

Ekonomia e Kosovës në vitin 2024 ka shënuar rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të kushteve makroekonomike. Sipas vlerësimeve tremujore të ASK-së, BPV reale ka shënuar rritje prej 4.4 përqind në vitin 2024, e mbështetur nga rënia e inflacionit dhe rritja e pagave. Konsumi shënoi rritje të lartë prej 5.0 përqind, që tregon një përmirësim të besimit të konsumatorëve dhe rritje të të ardhurave të familjeve. Investimet shënuan rritje prej 5.9 përqind. Në anën tjetër, eksportet neto, patën ndikim të theksuar negativ për shkak të rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve, duke thelluar deficitin tregtar. Sipas projeksioneve të BQK-së, ekonomia pritet të rritet me 4.2 përqind gjatë vitit 2025, me kontribuues kryesor konsumin, investimet dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë ndikim negativ.


**Në TM4 2024, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 4.1 përqind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafiku 4).** Rritja është nxitur kryesisht nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksportit. Në anën tjetër, importet ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik, për shkak të rritjes së kërkesës vendore dhe liberalizimit të vizave, që ka ndikuar në rritjen e importit.

Konsumi gjatë këtij tremujori është rritur për 3.4 përqind, që është një rritje më e ngadalësuar krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Ky ngadalësim i rritjes është ndikuar nga rritja më e ulët e burimeve të financimit, përfshirë kreditë konsumuese, kompensimin e punëtorëve, remitencat dhe konsumin publik. Investimet shënuan rritje më të lartë prej 9.0 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së kreditimit dhe investimeve publike. Indikacion i rritjes së investimeve është edhe rritja e importit të mallrave kapitale dhe IHD-ve në sektorin e patundshmërive.

Eksportet neto shënuan rritje të deficitit tregtar prej 6.7 përqind, për shkak të nivelit më të lartë të importit, i cili shënoi rritje prej 8.0 përqind për mallra dhe 11.4 përqind për shërbime. Edhe eksporti shënoi rritje, duke zbutur deri diku deficitin tregtar. Eksporti i shërbimeve shënoi rritje të ndjeshme prej 13.8 përqind, me eksportin e shërbimeve të udhëtimit si kategorinë kryesore, që shënoi një rritje nominale prej 12.5 përqind. Eksporti i mallrave gjithashtu është rritur me 4.7 përqind, kryesisht për shkak të rritjes së eksportit të metaleve bazë dhe produkteve ushqimore.


Rritja e aktivitetit ekonomik në TM4 2024 është mbështetur nga disa sektorë të ndryshëm. Industria përpunuese shënoi rritje prej 4.3 përqind, duke kontribuar në forcimin e eksporteve dhe prodhimit vendas.

Grafik 4. Rritja reale e BPV-së



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Grafik 5. Numri i ndërmarrjeve të reja




Burimi: ASK.

Tregtia u rrit me 4.1 përqind, për shkak të rritjes së konsumit dhe kërkesës për mallra, ndërsa ndërtimtaria shënoi rritje prej 3.9 përqind, si rezultat i investimeve në infrastrukturë dhe objekte rezidenciale. Rritja e aktivitetit ekonomik në këta sektorë ka pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara. Në TM4 2024, u regjistruan 3,034 ndërmarrje të reja, apo 7.6 përqind më shumë krahasuar me TM4 2023. Sektorët që kontribuan më shumë në këtë rritje janë hotelaria, ndërtimi, prodhimi, tregtia, bujqësia dhe transporti, ku është regjistruar numër më i madh i ndërmarrjeve të reja krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Në anën tjetër, sektorët e informacionit dhe komunikimit, aktiviteteve administrative dhe arsimit shënuan numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara (grafiku 6). Po ashtu, numri i ndërmarrjeve të mbyllura shënoi rritje për 8.3 përqind krahasuar me TM4 2023, duke arritur në 429 ndërmarrje.

### 3.2. Çmimet

**Inflacioni në Kosovë në TM4 2024 u ngadalësua në 0.7 përqind, nga 1.3 përqind në tremujorin paraprak.** Ky ngadalësim i atribuohet zgjerimit të kontributit negativ të çmimeve të energjisë, për shkak të rënies vjetore të çmimeve në këtë kategori dhe efektit të bazës. Për më shumë, ecuria rënëse e inflacionit u mbështet edhe nga rritja e ngadalësuar e çmimeve të mallrave të tjera dhe shërbimeve. Nga ana tjetër, rritja e përsheptuar e çmimeve të ushqimit rezultoi faktori kryesor nxitës i inflacionit në këtë periudhë (grafiku 6).

Grafik 6. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Çmimet e ushqimit shënuan rritje vjetore prej 2.3 përqind, që paraqet përsheptim kundrejt 1.2 përqind në tremujorin paraprak.** Në linjë me ecurinë e çmimeve të ushqimit në tregjet ndërkombëtare, presionet inflacioniste u rikthyen në çmimet e vajrave dhe yndyrave me rritje vjetore prej 7.2 përqind, bulmetit prej 3.9 përqind, dhe mishit prej 2.9 përqind. Presionet inflacioniste vijuan të jenë të theksuara në çmimet e pijeve joalkoolike veçanërisht në çmimet e kafesë, çajit, dhe kakaos që shënuan rritje vjetore prej 12.5 përqind.


**Çmimet e karburanteve shënuan rënie vjetore prej 10.3 përqind, duke ndjekur ecurinë rënëse të çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare.** Çmimet e lëndëve të ngurta djegëse rezultuan me rënie vjetore prej 5.5 përqind, që mund t'i atribuohet rritjes së përdorimit të pajisjeve më eficiente për ngrohje. Kurse, çmimet e energjisë elektrike rezultuan më të ulëta për 0.3 përqind, kryesisht për shkak të efektit të bazës në dhjetor 2023, pasi përgjatë tremujorit u evidentua rritje e çmimit si rezultat i rritjes së kërkesës për ngrohje.

**Kontributi i ushqimit në inflacion u rrit në 0.7 pikë përqindje, nga 0.4 pikë përqindje në tremujorin paraprak.** Kontribuuesit kryesor në inflacionin e ushqimit ishin çmimet e mishit dhe bulmetit me nga 0.2 pikë përqindje, dhe vajrave dhe yndyrave me 0.1 pikë përqindje. Kurse, rënia e çmimeve të frutave shënoi kontribut negativ prej 0.1 pikë përqindje.

**Kontributi i energjisë në inflacion në TM4 2024 u reduktua tutje duke arritur në -0.9 pikë përqindje, nga -0.4 pikë përqindje në tremujorin paraprak.** Kjo tkurrje reflekton rënien e çmimeve të karburanteve që kontribuoit me -0.8 pikë përqindje dhe të lëndëve të ngurta djegëse me kontribut prej -0.2 pikë përqindje. Çmimet e energjisë elektrike patën ndikim të vogël pozitiv prej 0.1 pikë përqindje në terma mesatarë tremujorë.

**Kontributi i çmimeve të mallrave tjera u zvogëlua marginalisht në 0.4 pikë përqindje nga 0.5 pikë përqindje në tremujorin paraprak,** kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të automjeteve, ndërsa kontributi nga rritja e çmimeve të mallrave tjera mbeti pothuajse i pandryshuar. Rënie e kontributit në inflacion u shënuar edhe nga sektori i shërbimeve, që rezultoi me kontribut prej 0.1 pikë përqindje në TM4 2024 nga 0.4 pikë përqindje në tremujorin paraprak. Kjo rënie e kontributit ishte kryesisht rezultat i rritjes së ngadalësuar të çmimeve të shërbimeve të transportit, ndikuar potencialisht nga rënia e çmimeve të karburanteve.

**Grafik 7. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit**




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Zbutja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në ngadalësimin e inflacionit bazë, i cili ra në 2.2 përqind në TM4 2024 nga 3.3 përqind në tremujorin paraprak (grafik 7).** Kjo rënie reflekton kryesisht rënien e çmimeve të automjeteve dhe çmimeve të komunikimit, si dhe rritjen e ngadalësuar të çmimeve të shërbimeve të transportit, rekreacionit dhe kulturës, veshjeve dhe këpucëve, etj.

**Ngadalësimi i inflacionit u pasqyrua edhe në zgjerimin e peshës së artikujve me rritje vjetore më të ulët se 1.0 përqind, që zuri 42.7 përqind të shportës së konsumit në TM4 2024, nga 35.0 përqind në tremujorin paraprak.** Rrjedhimisht, pesha e artikujve me rritje vjetore prej 1.0 – 3.0 përqind u tkurr në 33.3 përqind, ndërsa pesha e artikujve me rritje vjetore të çmimeve mbi 3.0 përqind shënoi rënie modeste në 24.0 përqind nga 25.9 përqind (grafik 8).

**Grafik 8. Pesha e artikujve në shportën e konsumit sipas normës së rritjes së çmimeve**



Burimi: ASK (2024) dhe kalkulimet e BQK-së.

**Sa i përket origjinës së inflacionit, presionet e inflacionit të importuar u tkurrën në 0.5 nga 1.0 pikë përqindje në TM3 2024,** kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të karburanteve dhe automjeteve, si dhe rritjes së ngadalësuar të çmimeve të shërbimeve të transportit dhe mallrave tjera. Në anën tjetër, presionet e brendshme inflacioniste u reduktuan në 0.2 pikë përqindje në TM4 2024 nga 0.4 pikë përqindje në TM3 2024, për shkak të ecurisë rënëse të çmimeve të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse të ngurta.

**Sa i përket origjinës së inflacionit, presionet e inflacionit të importuar u tkurrën në 0.5 nga 1.0 pikë përqindje në TM3 2024,** kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të karburanteve dhe automjeteve, si dhe rritjes së ngadalësuar të çmimeve të shërbimeve të transportit dhe mallrave tjera. Në anën tjetër, presionet e brendshme inflacioniste u reduktuan në 0.2 pikë përqindje në TM4 2024 nga 0.4 pikë përqindje në TM3 2024, për shkak të ecurisë rënëse të çmimeve të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse të ngurta.

**Indeksi i çmimeve të importit rezultoi me rritje vjetore prej 0.5 përqind në TM4 2024, pas një rënie prej 0.7 përqind në tremujorin paraprak.** Rënia vjetore e çmimeve të produkteve minerale (-3.9 përqind) dhe metaleve bazë (-1.3 përqind) u kompensua nga rritja e çmimeve të mjeteve të transportit (3.7 përqind), pajisjeve të makinerisë dhe atyre elektrike (2.0 përqind) dhe produkteve bimore (7.7 përqind).

**Po ashtu, indekset që sinjalizojnë koston e prodhimit të brendshëm, si indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) dhe ai i koston së ndërtimit (IKN), shënuan rritje të ngadalësuar.** IÇP shënoi rritje vjetore prej 8.5 përqind në TM4 2024 kundrejt 9.9 përqind në tremujorin paraprak, kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të prodhimit të energjisë elektrike prej 20.6 përqind, prodhimit të mobileve prej 10.3 përqind, dhe përpunimit

të produkteve ushqimore prej 6.9 përqind. IKN shënoi rritje vjetore prej 4.4 përqind, duke vijuar të nxitet nga rritja vjetore e pagave në ndërtimtari prej 12.8 përqind, rritja e çmimeve të energjisë elektrike (20.6 përqind), transportit (10.9 përqind), dhe më pak nga rritja e çmimeve të materialeve (2.7 përqind).

**Parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma e përgjithshme e inflacionit pritet të jetë rreth 3.3 përqind në vitin 2025.** Rikthimi i presioneve inflacioniste në tremujorin e parë të vitit 2025, u nxit kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit, si dhe nga ndikimi i pritjeve për inflacion pas njoftimit për rritjen e tarifave të energjisë elektrike. Rreziqet ndaj këtij projekcioni anojnë nga kahu rritës dhe përfshijnë: ecurinë rritëse në çmimet e ushqimit në tregjet ndërkombëtare, si dhe shkallën e transmetimit të kostove të rritura të energjisë elektrike në çmimet e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara brenda vendit.


### 3.3 Sektori Fiskal

Të hyrat primare buxhetore<sup>1</sup> në vitin 2024 arritën vlerën neto prej 3.1 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.0 përqind. Kjo rritje pasqyron dinamikat pozitive të aktivitetit ekonomik, përparimin në trajtimin e borxheve tatimore, përmirësimin të procesit të mbledhjes së të hyrave dhe aktiviteteve për luftimin e evazionit tatimor. Në të njëjtën kohë, shpenzimet buxhetore<sup>2</sup> shënuan rritje më të ngadalshme prej 8.3 përqind, duke arritur në 3.1 miliardë euro. Si rezultat, Buxheti i Kosovës në vitin 2024 ishte pothuajse i balancuar, me një deficit primar buxhetor shumë të ulët (-0.1 përqind si përqindje e BPV-së).

Megjithatë, në TM4 2024, dinamikat në sektorin fiskal ishin të ndryshme krahasuar me tremujorët paraprak, pasi kjo periudhë zakonisht karakterizohet nga realizimi më i lartë i shpenzimeve buxhetore. **Të hyrat buxhetore në TM4 2024 ishin 823.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.6 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 7.0 përqind dhe arritën vlerën prej 1.1 miliardë euro. Si pasojë e nivelit më të lartë të shpenzimeve buxhetore, Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 289.3 milionë euro në këtë tremujor.**

**Të hyrat tatimore në TM4 2024 arritën në 740.3 milionë euro, duke shënuar rritje prej 11.1 përqind krahasuar me TM4 2023.** Gjatë kësaj periudhe, shumica e kategorive tatimore shënuan rritje, me rritjen më të lartë të të hyrave tatimore direkte. Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej 10.7 përqind, duke arritur vlerën 126.4 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave shënuan rritje prej 17.2 përqind, tatimi në të ardhurat personale u rrit me 9.5 përqind dhe tatimi në pronë pati rritje më të vogël prej 1.0 përqind.

Grafik 9. Të hyrat tatimore sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: MFPT.


<sup>1</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga huazimet shtetërore.

<sup>2</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat për financim.

**Të hyrat nga tatimet indirekte shënuan rritje prej 10.1 përqind, duke arritur në 628.0 milionë euro, që përbëjnë 76.3 përqind të gjithë hyrave buxhetore.** Kjo rritje u ndikua kryesisht nga rritja e të hyrave nga TVSH për 10.9 përqind, duke arritur nivelin prej 417.6 milionë euro, nga detyrimi doganor 10.6 përqind si dhe nga akciza, e cila u rrit me 8.0 përqind si rezultat i rritjes së sasisë së importit (grafiku 9). **Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje më të lartë prej 16.8 përqind, duke arritur në 81.2 milionë euro.** Kjo kategori përfshinë të hyrat nga qeveria qendrore, të cilat arritën vlerën prej 45.8 milionë euro, me një rritje prej 18.7 përqind, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje prej 14.5 përqind, duke arritur në 19.2 milionë euro.

**Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 5.5 përqind.** Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për subvencione dhe transfere shënuan rritjen më të lartë prej 7.1 përqind, duke arritur vlerën 405.2 milionë euro. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 6.3 përqind dhe arritën vlerën 178.0 milionë euro. Shpenzimet për paga shënuan rritje më të ulët prej 1.4 përqind, duke arritur vlerën 203.2 milionë euro. **Shpenzimet kapitale shënuan rritje më të lartë krahasuar me shpenzimet rrjedhëse, duke arritur vlerën prej 326.5 milionë euro, që është për 10.8 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar (grafiku 10).**

Grafik 10. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: MFPT.

**Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u ul në 16.5 përqind në TM4 2024, krahasuar me 17.5 përqind në TM4 2023, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak u shënuar rritje për 1.1 pikë përqindje.** Kjo rritje e raportit të borxhit publik në tremujorin e fundit të vitit ishte rezultat i rritjes së deficitit buxhetor të qeverisë, duke shtuar nevojën për borxh. Në terma absolut, borxhi publik ishte 1.7 miliardë euro në TM4 2024, duke shënuar rritje prej 4.6 përqind krahasuar me TM4 2023. Kjo rritje u ndikua nga rritja e borxhit të jashtëm publik për 12.2 përqind, që arriti në 777.2 milionë euro. Ndërkohë, borxhi i brendshëm publik shënoi rënie të lehtë prej 0.8 përqind, duke arritur në 962.2 milionë euro.

Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrime ndaj institucioneve ndërkombëtare, si Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (me 34 përqind të borxhit të jashtëm), Bashkimi Evropian (13 përqind), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (10 përqind), Fondi Monetar Ndërkombëtar (10 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i brendshëm publik përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës (letrat me vlerë) ndaj fondeve pensionale (45 përqind), bankave komerciale (24 përqind), institucioneve publike (22 përqind), etj.


### 3.4. Sektori i jashtëm

Në vitin 2024, deficitin e llogarisë rrjedhëse shënoi rritje prej 25.4 përqind duke arritur në 914.8 milionë euro. Vetëm në TM4 2024, deficitin e llogarisë rrjedhëse arriti në 488.0 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.3 përqind (grafik 10). Faktorët kryesorë që kontribuan në zgjerimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse ishin përkeqësimi i bilancit tregtar të mallrave dhe rënia e të ardhurave dytësore. Ndërkohë, sektori i shërbimeve pati kontribut pozitiv, duke vazhduar të gjenerojë të ardhura të qëndrueshme, veçanërisht në sektorët e udhëtimit dhe teknologjisë informative. Për më tepër, të ardhurat parësore kishin ndikim lehtësues në deficitin e llogarisë rrjedhëse.


Deficiti tregtar në vitin 2024 u rrit me 7.5 përqind duke arritur vlerën prej 5.4 miliardë euro, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të importit të mallrave. Ky trend i rritjes u reflektua edhe në TM4 2024, ku deficitin tregtar i mallrave shënoi rritje prej 5.8 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak dhe arriti vlerën prej 1.5 miliardë euro (grafik 11). Kjo rritje është pasojë e zgjerimit të importeve, të cilat arritën vlerën në 1.8 miliardë euro, e ndikuar kryesisht nga rritja e sasisë së mallrave të importuara, veçanërisht produkteve minerale, makinerive dhe mjeteve të transportit. Në anën tjetër, eksportet mbetën në nivel të ulët, duke arritur në 253.0 milionë euro dhe mbuluar vetëm 14.2 përqind të importeve. Si pasojë, raporti tregtar i disfavorshëm prej 1:7 pasqyron thellimin e disbalancës tregtare. Varësia e lartë nga importet dhe kapacitetet e kufizuara eksportuese vazhduan të krijojnë sfida strukturore për ekonominë, duke e bërë të vështirë përmirësimin e bilancit tregtar. Ndërkohë, kërkesa e lartë për importin e mallrave ka ndikuar në varësinë nga tregjet ndërkombëtare për plotësimin e nevojave në vend.

Në vitin 2024, eksporti i mallrave arriti në 943.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.3 përqind. Ky trend u intensifikua në TM4 2024, ku eksportet u rritën me 13.8 përqind, duke arritur në 253.0 milionë euro. Kjo rritje u mbështet kryesisht nga performanca pozitive në disa sektorë, me eksportin e


Grafik 11. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Grafik 12. Bilanci tregtar i mallrave




Grafik 13. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



metaleve bazë si kategoria më e rëndësishme, e cila shënoi rritje prej 11.5 përqind, duke arritur në 52.9 milionë euro, e ndikuar nga rritja e kërkesës për metale në tregjet ndërkombëtare. Pas metaleve, eksporti i produkteve ushqimore shënoi rritje prej 17.4 përqind, duke arritur në 31.7 milionë euro. Eksporti i produkteve të plastikës dhe gomës pësoi rënie të lehtë prej 3.7 përqind, por mbeti një ndër sektorët kryesor për eksportin e mallrave duke arritur vlerën prej 29.9 milionë euro (grafik 12). Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor i Kosovës, me 46.6 përqind të gjithsej eksporteve, me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si destinacionet kryesore. Ndërsa vendet e BE-së përbëjnë 33.8 përqind të eksportit të përgjithshëm, me eksportet kryesore në Gjermani dhe Austri. Kjo strukturë e eksporteve tregon varësi të theksuar ndaj tregut rajonal, por pjesëmarrja e konsiderueshme në tregun evropian shfaq potencial të rëndësishëm për zgjerim dhe integrim në zinxhirët globalë të furnizimit.

**Importi i mallrave në vitin 2024 arriti në 6.4 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.8 përqind. Në TM4 2024, importi i mallrave arriti në 1.8 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6.9 përqind.** Kjo rritje është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila u reflektua në rritje prej 4.3 përqind në sasinë e përgjithshme të mallrave të importuara. Struktura e importeve mbetet e përqendruar në disa kategori kryesore, ku produktet minerale, makineritë (përfshirë pajisjet shtëpiake dhe mjetet e transportit) dominuan volumin e përgjithshëm të mallrave të importuara. Vendet e BE-së përfaqësojnë rreth 43.2 përqind të importeve, ku dominuan mjetet e transportit dhe produktet ushqimore. Ndërkohë, importet nga Turqia ishin 13.9 përqind të totalit, kryesisht të përqendruara te metalet bazë dhe makineritë, përfshirë veglat dhe pajisjet elektrike. Vendet e rajonit përbënin 13.8 përqind të importeve, ku produktet minerale dhe artikujt ushqimor kishin peshën kryesore.


**Grafik 14. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro**



Burimi: BQK.

**Në vitin 2024, bilanci i shërbimeve arriti në 1.8 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.9 përqind, ndjeshëm më e ngadalësuar kundrejt rritjes prej 18.7 përqind në vitin 2023. Megjithatë, në TM4 2024, bilanci i shërbimeve shënoi performancë të mirë, duke arritur në 275.5 milionë euro, rritje vjetore prej 19.5 përqind (grafik 14).** Eksporti i shërbimeve arriti në 631.3 milionë euro, rritje vjetore prej 15.6 përqind, e mbështetur kryesisht nga rritja e shërbimeve të udhëtimit. Ky segment, që përbën pjesën më të madhe të eksporteve të shërbimeve, u rrit me 12.5 përqind, duke arritur në 373.3 milionë euro, si rezultat i shtimit të numrit të udhëtarëve dhe vizitave nga diaspora. Rritja e eksportit të shërbimeve u ndikua edhe nga shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit, me rritje prej 24.0 përqind, duke arritur vlerën 101.8 milionë euro. Po ashtu, shërbimet e tjera të biznesit kanë kontribuar me rritje të theksuar prej 12.2 përqind, duke arritur vlerën prej 68.6 milionë euro. Nga ana tjetër, importi i shërbimeve u rrit me 12.7 përqind, kryesisht për shkak të rritjes së importit të shërbimeve të udhëtimit, me 21.0 përqind, duke arritur në 137.5 milionë

**Grafik 15. Bilanci i shërbimeve**



Burimi: BQK.


euro, që përbën 38.8 përqind të gjithë importit të shërbimeve. Po ashtu, importi i shërbimeve të transportit shënoi rritje të konsiderueshme prej 28.7 përqind, duke arritur në 90.8 milionë euro. Zgjerimi i vazhdueshëm i eksportit të shërbimeve të IT-së dhe shërbimeve të tjera të biznesit është tregues i rëndësishëm i transformimit të sektorit të shërbimeve dhe diversifikim të eksportit. Megjithatë, rritja e importit të shërbimeve, veçanërisht në sektorin e udhëtimit, mund të ketë ndikime negative në bilancin e përgjithshëm të shërbimeve.

**Bilanci i të ardhurave parësore në vitin 2024 arriti vlerën prej 218.2 milionë euro, duke shënuar rritje prej 9.7 përqind. Në TM4 2024, rritja ishte 7.6 përqind, duke arritur në 102.3 milionë euro, kundrejt 95.1 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2023 (grafik 15).** Kompensimi i punëtorëve ka kontribuar ndjeshëm në këtë përmirësim, me rritje vjetore prej 16.6 përqind, duke arritur në 109.9 milionë euro. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave nga investimet ka vazhduar trendin negativ, duke shënuar bilanc negativ prej 15.1 milionë euro, si pasojë e rritjes së bilancit negativ të investimeve direkte dhe ndikuar kryesisht nga fitimet e ri investuara dhe shpërndarja e dividendëve nga IHD-të.


**Në vitin 2024, remitencat, si një ndër burimet kryesore e të hyrave dytësore në bilancin e pagesave, arritën vlerën prej 1.35 miliardë euro, duke shënuar rritje të ngadalësuar prej 1.4 përqind krahasuar me rritjen prej 9.2 përqind në vitin 2023. Gjatë TM4 2024, remitencat e pranura arritën vlerën 344.2 milionë euro, duke reflektuar tendencën e ngadalësimit të rritjes me vetëm 3.0 përqind.** Ky ngadalësim mund të jetë pasojë e pasigurisë ekonomike dhe inflacionit ende të lartë në vendet ku jeton dhe punon diaspora kosovare, duke reduktuar mundësinë e tyre për të dërguar remitencat. Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave, të cilat përbëjnë 56.5 përqind të gjithë remitencave, e ndjekur nga SHBA-të dhe vendet tjera të BE-së. Remitencat përmes kanaleve formale, si bankat dhe agjencitë për transferim të parave, shënuan rritje prej 1.6 përqind, ndërsa remitencat përmes kanaleve joformale shënuan rritje prej 6.8 përqind.

**Në vitin 2024, IHD-të arritën në 847.4 milionë euro dhe shënuan rritje të ngadalësuar prej 0.9 përqind, ndjeshëm më e ulët krahasuar me rritjen prej 14.8 përqind në vitin 2023. Ky ngadalësim u reflektua veçanërisht në TM4 2024, ku IHD-të shënuan rënie prej 17.1 përqind, duke u tkurrur në 183.4 milionë euro.** Megjithatë, rritja e investimeve në sektorin e patundshmërisë ka qenë faktor balancues në bilancin e përgjithshëm të IHD-ve. Investimet në këtë sektor u rritën me 24.3 përqind, duke arritur në 179.5 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe kërkesës së lartë për patundshmëri. Në anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit shënuan rritje të dukshme gjatë TM4

Grafik 16. Bilanci i të ardhurave parësore




Grafik 17. Remitencat




2024, duke arritur në 64.3 milionë euro, krahasuar me 28.2 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2023. Këto investime ishin kryesisht të orientuara në sektorin e patundshmërisë në vendet e rajonit, duke reflektuar diversifikim të kapitalit dhe kërkesën në rritje për investime jashtë Kosovës.

Grafik 18. Investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Grafik 19. Investimet e huaja direkte sipas sektorëve



Burimi: BQK.

## 4. Sistemi financiar


**Sistemi financiar në vend ka vazhduar të zgjerohet, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024.** Asetet e sistemit financiar në dhjetor 2024 arritën vlerën 12.75 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.7 përqind nga 12.4 përqind në dhjetor të vitit paraprak (grafiku 20). Sektori bankar, fondet pensionale dhe ndihmësit financiarë u karakterizuan me rritje vjetore të përshpejtuar, ndërsa sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar.

Kontributin kryesor në zgjerimin e sistemit financiar në vend vazhdon ta ketë rritja e përshpejtuar e sektorit bankar, i cili përfaqëson sektorin me peshën më të madhe në kuadër të sistemit financiar, me një pjesëmarrje prej 67.1 përqind në dhjetor 2024 (grafiku 21). Po ashtu, rritja e përshpejtuar e aseteve të fondeve pensionale ka kontribuar në zgjerimin e sistemit financiar, dhe njëkohësisht ka rritur pjesëmarrjen e fondeve pensionale në total asetet e sistemit financiar në 25.0 përqind nga 24.4 përqind në vitin paraprak. Sektori mikrofinanciar ka shënuar rritje vjetore më të ngadalësuar prej 20.5 përqind nga 34.8 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, sektori i sigurimeve ka shënuar ngadalësim të rritjes vjetore në 9.8 përqind nga 12.7 përqind një vit më parë. Ndërsa, sektori i ndihmësve financiarë ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 15.0 përqind, pas rënies së theksuar prej 64.4 përqind në vitin e kaluar që ishte pasojë e riklasifikimit të dy operatorëve nga ndihmës financiarë në IMF/IFJB.

### 4.1. Sektori bankar


Asetet e sektorit bankar arritën në 8.56 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 13.5 përqind nga 11.5 përqind në dhjetor të vitit paraprak (grafiku 22). Zgjerimi i shpejtë i aktivitetit kreditues, ashtu si në tremujorin e kaluar, ishte faktori kryesor që ndikoi në zgjerimin e aseteve të sektorit bankar. Kjo ka rezultuar gjithashtu në rritje të pjesëmarrjes së kredive në asetet totale, duke arritur në 67.9 përqind, apo rritje prej 2.8 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar.

Grafik 20. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK.

Grafik 21. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 22. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Burimi: BQK.

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, si kategoria e dytë më e rëndësishme për nga kontributi në rritjen e aseteve, ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 13.4 përqind nga rritja vjetore prej vetëm 3.9 përqind një vit më parë. Ndërsa, kategoria e letrave me vlerë ka shënuar një ngadalësim të rritjes vjetore në 10.8 përqind nga 19.0 përqind në vitin paraprak, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të rritjes së investimeve në tregjet e jashtme. Nga ana tjetër, bilanci me bankat komerciale ka pësuar rënie të ndjeshme prej 17.8 përqind nga rritja prej 4.3 përqind vitin e kaluar, dhe si rezultat kishte kontribut negativ në rritjen e total aseteve të sektorit bankar. Rënia e kësaj kategorie reflekton, ndër tjera, riorientimin strategjik drejt mbështetjes së rritjes së përshpejtuar të kreditimit gjatë periudhës së raportuar.

**Kreditimi ka shënuar trend të rritjes së vazhdueshme gjatë vitit 2024, me theks të veçantë në tremujorin e katërt të vitit. Stoku i gjithsej kredive ka shënuar rritje vjetore prej 18.3 përqind apo për 5.3 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin paraprak.** Po ashtu, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, stoku i kredive ka shënuar rritje prej 5.4 përqind. Ky përshpejtim i rritjes së kredive është reflektuar nga rritja e theksuar e kreditimit, si për ekonomitë familjare, ashtu edhe për korporatat jo-financiare (grafiku 23 dhe 24). Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar (AKBK), tregojnë se dinamikat e kreditimit gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024 u ndikuan kryesisht nga kërkesa e rritur kreditore nga ekonomitë familjare dhe nga korporatat jo-financiare. Në anën tjetër, oferta mbeti relativisht e pandryshuar për ekonomitë familjare, ndërkohë që kishte lehtësime të vogla për segmentin e NVM-ve në kuadër të korporatave jo-financiare, në aspekt të normave të interesit dhe kërkesave për kolateral. Kërkesa e shtuar për kredi nga ndërmarrjet, u ndikua kryesisht nga nevoja për financim të investimeve fikse dhe kapitalit punues. Ndërsa, kërkesa e shtuar për kredi nga ekonomitë familjare, u ndikua nga rritja e besueshmërisë së konsumatorëve, rritja e shpenzimeve të tjera për konsum dhe perspektiva e mirë e tregut të patundshmërive. Oferta kreditore, në anën tjetër, ashtu si në tremujorin paraprak, u ndikua pozitivisht nga faktorë si rënia e normës Euribor, mbështetja nga Fondi i Kosovës për Garanci Kreditore (FKGK), dhe pozita e mjaftueshme e likuiditetit të bankave. Megjithatë, këto efekte pozitive u neutralizuan në masë të madhe nga toleranca më e ulët për të ndërmarrë rreziqe si dhe shqetësimet lidhur me cilësinë e portofolit kreditor.


Kontributin kryesor në zgjerimin e kreditimit të sektorit bankar gjatë tremujorit të katërt e kishte segmenti i korporatave jo-financiare, kreditë investive të së cilit u rritën ndjeshëm. Kreditë për KJF-të vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive, dhe në dy vitet e fundit rritja në këtë segment është karakterizuar me rritje të stokut të kredive me maturitet afatshkurtër kundrejt atyre me maturitet afatgjatë. Megjithatë, segmenti i ekonomive familjare është duke zgjeruar relativisht shpejtë pjesëmarrjen e saj në gjithsej kreditimin e sektorit, duke shënuar rritje më të lartë të stokut të kredive me afate më të gjata maturimi. Krahas rritjes së përgjithshme të

**Grafik 23. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor**



Burimi: BQK.

**Grafik 24. Kontributi në rritjen e gjithsej kredive, në pikë përqindje**




Burimi: BQK.

kreditimit, është rritur gjithashtu përfshirja financiare, përkatësisht numri i kredimarrësve të rinj. Në dhjetor 2024, numri i kredimarrësve të rinj, sipas databazës së Regjistrimit të Kredive, arriti në 23 mijëduke shënuar një rritje vjetore prej 6.8 përqind nga 2.0 përqind rritje vjetore e kredimarrësve të rinj në dhjetor të vitit 2023.

**Segmenti i korporatave jo-financiare ka shënuar rritje vjetore të përsheptuar të stokut të kredive prej 15.3 përqind, për 5.2 pikë përqindje më e lartë se në vitin paraprak. Ky zhvillim reflekton rritjen e lartë të kredive të reja investive ndaj KJF-ve gjatë këtij tremujori, krahasuar me një vit më parë.** Aktiviteti kreditues i KJF-ve sipas sektorëve ekonomik, u karakterizua me përsheptim të rritjes në sektorë të caktuar si; tregtia me shumicë, sektori i shërbimeve financiare dhe prodhimtaria, përkundër që aktiviteti ekonomik i sektorëve të lartpërmendur ka shënuar ngadalësim të rritjes reale. Kurse, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë shënoi rënie përkundër rritjes së aktivitetit ekonomik të këtij sektori. Më konkretisht, sektori i tregtisë me shumicë shënoi rritje vjetore prej 16.0 përqind dhe njëherësh mbetet kategoria me kontributin më të madh në dinamikën e kredive të ndërmarrjeve, për shkak të peshës dominuese prej 42.0 përqind (grafik 25). Sektori i shërbimeve financiare dhe ai i prodhimtarisë kanë shënuar rritje vjetore prej 26.7 përqind dhe 11.9 përqind, përkatësisht (grafik 26). Sektori i ndërtimtarisë ka shënuar ngadalësim të rritjes vjetore për 5.3 pikë përqindje, duke zbritur në 10.6 përqind. Ndërsa, bujqësia shënoi rënie vjetore të theksuar prej 9.2 përqind krahasuar me rritjen prej 25.8 përqind në vitin paraprak. Kreditë e reja për korporatat jo-financiare, pas një ngadalësimi të rritjes në tremujorin paraprak, shënuan rritje vjetore të përsheptuar gjatë këtij tremujori. Ato shënuan rritje prej 18.3 përqind, për 11.3 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin e kaluar. Kjo dinamikë u ndikua nga rritja e kredive të reja për qëllime investive, të cilat shënuan rritje prej 42.2 përqind krahasuar me 3.6 përqind një vit më parë. Në kuadër të kredive të reja investuese, me rritje u karakterizuan kreditë e reja investuese për sektorin e shërbimeve dhe industrisë, të cilët shënuan rritje prej 51.4 përqind dhe 50.5 përqind, përkatësisht. Ndërsa, kreditë për qëllime jo-investive shënuan rënie prej 10.5 përqind nga rritja prej 15.6 përqind një vit më parë, dhe si rezultat kishin kontribut negativ në rritjen e gjithsej kredive të reja për korporatat jo-financiare.


**Segmenti i ekonomive familjare ka vazhduar trendin e rritjes së përsheptuar, ndikuar nga zgjerimi i kredive konsumuese dhe atyre hipotekare. Gjithsej kreditimi ndaj ekonomive familjare ka shënuar rritje vjetore të stokut të kredive prej 22.0 përqind nga 17.3 përqind në vitin e kaluar (grafiku 27).** Kontributin kryesor në këtë rritje e kishin kreditë e reja konsumuese, të cilat shënuan rritje vjetore të

**Grafik 25. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik**



Burimi: BQK.

**Grafik 26. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike**




Burimi: BQK.

përsheptuar prej 27.1 përqind nga 23.2 përqind një vit më parë. Po ashtu, për dallim nga viti i kaluar, një kontribut pozitiv në rritjen e kreditimit për ekonomitë familjare kishin edhe kreditë e reja hipotekare, të cilat rikthyen trendin pozitiv të rritjes, duke shënuar rritje vjetore prej 37.9 përqind nga rënia prej 11.3 përqind në vitin paraprak. Krahas zgjerimit të stokut, struktura e maturimit të kredive të ekonomive familjare ka pësuar ndryshim gradual, duke u orientuar gjithnjë më shumë drejt kredive me afat më të gjatë maturimi si dhe shuma më të larta. Konkretisht, kategoria 'mbi 10 vite' ka zgjeruar pjesëmarrjen në 36.7 përqind, për 2.3 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë, dhe krahasuar me pesë vite më parë është rritur për 20.6 pikë përqindje. Gjithsesi, kategoria dominuese vazhdoi të jetë ajo e maturitetit '5 deri në 10 vite', me pjesëmarrje prej 42.9 përqind.

Sipas të dhënave nga databaza e Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK), kreditë e reja të disbursuara për ekonomitë familjare gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 kishin një vlerë mesatare prej 10.3 mijë euro dhe afat mesatar maturimi prej 4.9 vitesh. Më konkretisht, në aspekt të vlerës së kredive të reja të lëshuara në këtë periudhë, 34.5 përqind e tyre ishin në intervalin prej 10-30 mijë euro, duke u pozicionuar si kategoria dominuese për ekonomitë familjare. Ndërsa, në aspekt të numrit të kredive të disbursuara, kjo kategori kishte pjesëmarrje prej 18.5 përqind. Kreditë në intervalin 30-60 mijë euro kishin pjesëmarrje prej 5.7 përqind në numër, ndërsa 22.7 përqind në vlerë të gjithsej kredive. Kreditë me vlerë të barabartë apo mbi 60 mijë euro, - të cilat kryesisht përfshijnë kreditë hipotekare dhe lizingjet - përfaqësuan vetëm 1.9 përqind të numrit të kredive por në kuadër të vlerës kishin pjesëmarrje prej 22.1 përqind. Kurse, kreditë në vlerë nën 500 euro, të cilat përfaqësojnë kryesisht borxhin e shfrytëzuar në kreditë kartela, kishin pjesëmarrje prej 22.1 përqind në numër, ndërsa vetëm 0.86 përqind në aspekt të vlerës. Në aspektin e maturitetit, kreditë me kohëzgjatje 3-5 vite ishin dominuese sipas numrit, me pjesëmarrje prej 44.1 përqind.


Ndërkohë, kreditë me maturitet 5-10 vite përfaqësuan 37.8 përqind të vlerës totale të kredive të reja të

Grafik 27. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 28. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.

Grafik 28 a. Diferenca (mil. €) dhe ndryshimi i vlerës (%) së depozitave në kuartale



Burimi: BQK.


disbursuara për ekonomi familjare, duke konfirmuar tendencën e një zhvendosje drejt financimeve me afate më të gjata dhe vlera më të larta.

**Vlera e depozitave në sektorin bankar arriti në 6.92 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 13.0 përqind nga 10.4 përqind në vitin paraprak (grafik 28).** Në përputhje me sezonalitetin tipik të depozitave – rritje më e theksuar e depozitave gjatë pjesës së dytë të vitit, ato shënuan rritje të theksuar për kuartalin e dytë me radhë (grafik 28 a). Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë rreth 65.1 përqind të gjithsej portfolios së depozitave, kanë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel të rritjes nga viti i kaluar, apo rritje prej 11.1 përqind nga 11.3 përqind në vitin paraprak. Po ashtu, depozitat prej korporatave jo-financiare shënuan rritje vjetore prej 12.3 përqind nga 12.9 përqind. Ndërsa, depozitat e korporatave të tjera financiare dhe korporatave publike shënuan një rritje vjetore të përsheptuar prej 34.2 përqind dhe 20.6 përqind, apo rritje nga viti paraprak për 28.4 dhe 32.4 pikë përqindje, respektivisht (grafiku 29). Ky zhvillim është ndikuar kryesisht nga depozitorët e mëdhenj, të cilët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të rritjes në këto kategori, veçanërisht nga sektori i fondeve pensionale, kompanive të sigurimit dhe sektori i energjisë. Nevoja për likuiditet nga bankat dhe konkurrenca ndërbankare për të mbajtur dhe tërhequr depozitorët e mëdhenj ka ndikuar në ofrimin e normave atraktive të interesit për klientët institucional. Në tremujorin e fundit të vitit 2024, depozitat përbënin 80.9 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit bankar, duke shënuar rënie vjetore për 0.4 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rritjes së bilancit nga bankat komerciale.


**Depozitat e reja, që përfshijnë vetëm depozitat e afatizuara, përsheptuan ritmin e rritjes vjetore si për ekonomitë familjare, ashtu dhe për korporatat jo-financiare.** Vlera e depozitave të reja arriti në 1.17 miliardë euro në fund të dhjetorit 2024, duke shënuar rritje vjetore prej 34.8 përqind nga 11.3 përqind një vit më parë. Segmenti i ekonomive familjare ka vazhduar trendin e rritjes së përsheptuar, duke shënuar rritje vjetore prej 42.0 përqind nga 36.4 përqind në vitin paraprak. Depozitat e reja të korporatave jo-financiare, gjithashtu shënuan rritje të lartë prej 20.7 përqind pas një rënie të ndjeshme prej 18.4 përqind në vitin e kaluar (grafiku 30).

**Normat e interesit në sektorin bankar në vend kanë pësuar rënie graduale në kredi, ndikuar nga zhvillimet në nivel global, ku pjesa më e madhe e bankave qendrore lehtësuan tutje politiken e tyre monetare.** Ndërkohë, nevoja për likuiditet e bankave dhe konkurrenca e rritur ndërbankare, ka kontribuar në rritjen e normave të interesit në depozita. Në dhjetor të vitit 2024, norma e interesit në kredi zbriti në 5.9 përqind nga 6.3 përqind sa ishte një vit më parë. Ndërkohë, konkurrenca e lartë ndër-bankare për tërheqjen e depozitave ka ndikuar në rritjen e normës së interesit të depozitave, e cila arriti në 3.4 përqind nga 3.1 përqind vitin paraprak. Si rezultat i uljes së normave të interesit në kredi dhe rritjes së normës së

**Grafik 29. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje**




**Grafik 30. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor**




interesit në depozita, margjina e interesit kredi-depozitë ka arritur nivelin më të ulët ndër vite, duke zbritur në 2.5 pikë përqindje në dhjetor 2024, nga 3.2 pikë përqindje në dhjetorin e vitit paraprak dhe në tremujorin e kaluar (grafiku 31).

Trendi rënës i normës së EURIBOR-it ka ndikuar në strukturën e kredive sipas llojit të normave të interesit, duke e bërë më pak atraktive për bankat ofrimin e kredive me normë variabile. Si rezultat, në dhjetor 2024, pjesëmarrja e kredive me normë variabile të interesit zbriti në 29.6 përqind, nga 33.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo pjesëmarrje ka pësuar gjithashtu një rënie prej 0.9 pikë përqindje krahasuar me tremujorin paraprak (grafiku 32).

Grafik 31. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Grafik 32. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit




**Në dhjetor 2024, norma mesatare e interesit në kredi si ndaj korporatave jofinanciare dhe ndaj ekonomive familjare ka shënuar një rënie vjetore prej 0.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak.** Përkatësisht, norma e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare zbriti në 6.0 përqind, ndërsa për ekonominë familjare në 5.7 përqind. Në kuadër të KJF-ve, norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për sektorin e industrisë dhe shërbimeve, me një mesatare prej 5.9 përqind (grafiku 33). Ndërsa, në kuadër të ekonomive familjare, normat më të favorshme të interesit janë aplikuar për kreditë hipotekare, me një mesatare prej 4.9 përqind, përderisa kreditë konsumuese në mesatare kishin normë interesi prej 6.0 përqind (grafiku 34). Krahasuar me tremujorin e kaluar, norma e interesit për kreditë hipotekare ka shënuar rënie për 0.2 pikë përqindje, ndërsa për ato konsumuese mbetën të ngjashme, me rënie marginale për 0.02 pikë përqindje.

Grafik 33. Norma e interesit në kredi për korporatat jo-financiare



Burimi: BQK.


Grafik 34. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

**Normat e interesit në depozita arritën në 3.4 përqind, duke shënuar rritje për 0.2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë dhe rritje për 0.5 pikë përqindje nga tremujori i kaluar.** Në dhjetor 2024, norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jo-financiare ka shënuar rritje vjetore për 0.4 pikë përqindje, duke arritur në 4.1 përqind. Po ashtu, për ekonomitë familjare norma mesatare e interesit ka shënuar rritje vjetore për 0.5 pikë përqindje, duke arritur në 2.9 përqind (grafiku 35).

Grafik 35. Normat e interesit për depozita




Burimi: BQK.

### Profiti neto i sektorit bankar në dhjetor 2024

arriti në 182.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të përsheptuar prej 17.3 përqind nga 10.7 përqind një vit më parë. Kjo dinamikë është rezultat i rritjes më të lartë të hyrave kundrejt rritjes më të ngadalësuar të shpenzimeve. Gjithsej të hyrat arritën në 503.3 milionë euro, dhe u karakterizuan me rritje vjetore prej 15.7 përqind. Kontributin kryesor në rritjen e të hyrave kishin të hyrat nga interesi, të cilat përfaqësojnë 76.0 përqind të gjithsej të hyrave të sektorit, duke shënuar rritje vjetore prej 18.1 përqind. Përkundër rritjes së përsheptuar të kreditimit, rënia e normës mesatare të interesit në kredi gjatë kësaj periudhe ka ndikuar në rritje vjetore më të ngadalësuar të të hyrave nga interesi nga kreditë apo rritje prej 17.4 përqind nga 23.1 përqind në vitin paraprak. Të hyrat nga letrat me vlerë gjithashtu shënuan një ngadalësim të rritjes në 37.9 përqind nga 48.5 përqind, duke reflektuar rritjen më të ngadalësuar të investimeve në letra me vlerë krahasuar me vitin paraprak. Po ashtu, si rezultat i rënies së bilancit me bankat komerciale gjatë këtij tremujori, të hyrat nga plasmanët me bankat shënuan ngadalësim të rritjes vjetore gjatë kësaj periudhe. Kategoria e të hyrave nga jo interesi, e që janë kryesisht të hyra nga tarifat dhe komisionet, shënoi rritje prej 8.4 përqind nga 3.2 përqind një vit më parë, duke arritur vlerën prej 103.7 milionë euro në fund të dhjetorit

Grafik 36. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.


2024. Mirëpo, përkundër rritjes vjetore të përsheptuar, të hyrat nga jo-interesi shënuan rënie vjetore të pjesëmarrjes në kuadër të gjithsej të hyrave të sektorit në 20.6 përqind nga 22.0 përqind. Kjo si rezultat i rritjes më të lartë së të hyrave nga interesi në raport me të hyrat nga jo-interesi.

**Shpenzimet e sektorit bankar arritën vlerën 321.2 milionë euro, duke shënuar ngadalësim të rritjes vjetore në 14.9 përqind nga 21.5 përqind një vit më parë.** Kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej shpenzimeve e kishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, dhe e shpenzimeve të interesit. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative me pjesëmarrje prej 57.1 përqind, arritën në 183.2 milionë euro apo rritje vjetore prej 16.9 përqind nga 15.9 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, shpenzimet e interesit shënuan rritje vjetore më të ngadalësuar prej 42.2 përqind nga rritja prej 55.4 përqind në vitin paraprak, si rrjedhojë e efektit të bazës së rritjes më të lartë në vitin paraprak.

Rritja vjetore më e lartë e fitimit të sektorit në raport me rritjen e kapitalit, ndikoi që treguesi i Kthimit në Kapital të rritet në 19.9 përqind nga 19.7 përqind një vit më parë. Po ashtu, kthimi në asete ka shënuar rritje, duke arritur në 2.6 përqind nga 2.5 përqind vitin e kaluar, si rezultat i rritjes më të përsheptuar të fitimit në raport me rritjen e aseteve (grafiku 36).

**Kreditë jo-performuese të sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 11.0 përqind nga 12.1 përqind në vitin paraprak.** Si rezultat i rritjes vjetore më të ngadalësuar të kredive jo-performuese dhe rritjes së përsheptuar të gjithsej kredive, raporti i tyre shënoi rënie për 0.1 pikë përqindje, duke zbritur në 1.9 përqind (grafiku 37). Ndërsa, mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë shënoi rënie në 123.9 përqind nga 145.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, si rezultat i rënies së vlerës së provizioneve të ndara për mbulimin e kredive.

**Grafik 37. Ndryshimi vjetor i vlerës së KJP-ve dhe Raporti i KJP-ve ndaj gjithsej kredive**




Burimi: BQK.

**Norma e kredive jo-performuese për segmentin e korporatave jofinanciare shënoi rënie për 0.2 pikë përqindje, ndërsa për segmentin e ekonomive familjare shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje nga viti paraprak.** Më saktësisht, raporti i kredive jo-performuese për korporatat jo-financiare zbriti në 2.2 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare arriti në 1.5 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me një rritje të lartë të ekspozimeve jo-performuese, duke shënuar rritje prej 35.9 përqind nga 36.1 përqind një vit më parë. Krahësuar me tremujorin paraprak, raporti i kredive jo-performuese ndaj ekonomive familjare mbeti i pandryshuar. Ndërsa, për segmentin e korporatave jo-financiare, ekspozimet jo-performuese ngadalësuan ritmin e rritjes në 3.1 përqind nga 5.0 përqind rritje në vitin e kaluar. Krahësuar me bilancin në fund të tremujorit paraprak, vlera e kredive jo-performuese për korporatat jo-financiare ka shënuar rënie prej 8.8 përqind në raport me rritjen prej 5.5 përqind të vlerës së kredive, duke ndikuar që raporti i kredive jo-performuese për këtë segment të shënoi rënie për 0.4 pikë përqindje nga tremujori paraprak. Sektori i shërbimeve dhe tregtisë kishin rënie vjetore të raportit të KJP-ve ndaj kredive për 1.6, dhe 0.4 pikë përqindje respektivisht, duke rezultuar në normë të KJP-ve prej 2.4 përqind për sektorin e shërbimeve dhe 1.5 përqind për tregtinë. Në anën tjetër, sektorët që shënuan rritje vjetore të vlerës së KJP-ve ishin prodhimtaria dhe bujqësia. Norma e KJP-ve arriti në 2.8 përqind nga 2.2 përqind për sektorin e prodhimitarisë dhe 6.6 përqind nga 4.8 përqind për atë të bujqësisë.

**Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, ka zbritur në 16.2 përqind nga 17.4 përqind një vit më parë.** Rënia për 1.2 pikë përqindje e normës

së kapitalizimit u ndikua nga rritja më e lartë e mjeteve të peshuara me rrezik në raport me atë të kapitalit rregullativ. Koncretisht, kapitali rregullativ i sektorit në fund të tremujorit të katërt të vitit 2024 shënoi rritje vjetore prej 7.4 përqind nga 27.3 përqind një vit më parë. Kurse mjetet e peshuara me rrezik kanë shënuar përshejtim të rritjes në 15.6 përqind nga 13.4 përqind në dhjetor 2023, kryesisht si rezultat i rritjes së lartë të kreditimit: ekspozimeve ndaj individëve dhe NVM-ve dhe kredive hipotekare me pronë të paluajtshme komerciale (grafiku 38).


Grafik 38. Treguesi i solvencës



### Treguesit e likuiditetit dhe financimit,

**përkundër trendit rënës, qëndruan mbi nivelet minimale rregullatore.** Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) qëndroi lartë mbi minimumin prej 100 përqind të kërkuar me rregullore, përkatësisht në 210.9 përqind në dhjetor 2024, mirëpo krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shënoi rënie për 68.9 pikë përqindje. Ky nivel dëshmon se bankat mbajnë mjaftueshëm mjete likuide për të plotësuar nevojat dalëse (rrjedhjes së parasë) për një periudhë 30 ditore. Po ashtu, edhe treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) shënoi rënie në 136.0 përqind nga 150.3 përqind në dhjetor 2023, por mbetet mbi minimumin rregullativ prej 100 përqind duke sugjeruar se bankat disponojnë financim të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm për të mbuluar kërkesat më afatgjata të financimit/likuiditetit. Tutje, raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra - shënoi rënie vjetore për 2.0 pikë përqindje, duke zbritur në 32.6 përqind. Kjo si rezultat i rritjes vjetore më të theksuar të detyrimeve afatshkurtra prej 14.4 përqind në raport me rritjen e mjeteve likuide prej 7.6 përqind. Gjithashtu, rritja më e lartë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar në rritjen e raportit kredi-depozitë për 3.8 pikë përqindje, duke arritur në 84.0 përqind (grafiku 39).

Grafik 39. Treguesit e likuiditetit



## 4.2. Sektori pensional

Asetet e sektorit pensional arritën vlerën 3.2 miliardë euro në fund të dhjetorit 2024, duke shënuar një rritje të përshpejtuar vjetore prej 17.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 12.1 përqind një vit më parë (grafiku 40).

Sektori pensional e përmbylli vitin me një kthim bruto nga investimet prej 248.4 milionë euro, duke shënuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me 88.5 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kjo performancë u mbështet nga dinamikat pozitive në tregjet ndërkombëtare, të mbështetura nga përmirësimi i treguesve makroekonomik global si pasojë e rënies së inflacionit, politikës monetare lehtësuese të bankave qendrore, si dhe avancimeve në sektorin e teknologjisë (inteligjencës artificiale) të cilat kontribuan në fitime të larta në tregjet financiare. Ndërkohë, arkëtimet nga kontributet shënuan një rritje të lehtë, duke arritur në 316.5 milionë euro nga 286.8 milionë euro një vit më parë.


Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), që mbulon 99.7 përqind të totalit të aseteve në sektorin pensional, arriti vlerë të aseteve prej 3.2 miliardë euro, duke shënuar rritje të ndjeshme vjetore prej 17.8 përqind krahasuar me rritjen prej 12.1 përqind në vitin paraprak. Në mënyrë të ngjashme, Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP) shënoi një rritje vjetore prej 13.6 përqind, nga 9.9 përqind një vit më parë dhe arriti vlerën e aseteve në 10.7 milionë euro.

**Të dy fondet kanë ndjekur një qasje të ngjashme investimi, duke rritur ekspozimin në tregjet e jashtme dhe reduktuar investimet në tregun e brendshëm (grafiku 41).**

FKPK vazhdoi zgjerimin e investimeve në tregun e jashtëm me një vlerë totale prej 2.5 miliardë euro, duke rritur pjesëmarrjen e tyre në portofol në 79.2 përqind nga 74.5 përqind një vit më parë. Investimet janë fokusuar kryesisht në fondet e përbashkëta (99.9 përqind të totalit), ndërsa 1.2 milionë euro janë mbajtur në formën e parasë së gatshme.


Ndryshe, FSKP zvogëloi investimet në tregun e brendshëm për 27.8 milionë euro në dhjetor 2024. Paraja e gatshme dhe depozitat në BQK shënuan një rënie të ndjeshme prej 45.2 përqind dhe 92.8 përqind, respektivisht, si rezultat i orientimit të investimeve drejt alternativave më fitimprurëse, si letra me vlerë dhe certifikata depozitash. Megjithatë investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u rritën me 11.4 përqind në vitin 2024, duke përmbytur rënien prej 19.3 përqind një vit më parë, pesha e tyre në totalin e investimeve zbriti në 15.7 përqind nga 16.5 përqind. Kjo rënie pasqyron ritmin më të ngadalshëm të rritjes së investimeve në letra me vlerë krahasuar me zgjerimin e gjithsej aseteve. Ndërkohë, investimet në certifikatat e depozitave në bankat vendore shënuan një rritje të përshpejtuar prej 68.8 përqind në vitin 2024, pas një rënie prej 34.2 përqind një vit më

Grafik 40. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Grafik 41. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP.

parë. Pavarësisht kësaj rritje të ndjeshme, pesha e tyre në totalin e investimeve u rrit vetëm lehtësisht, duke arritur në 4.8 përqind nga 3.3 përqind, pa ndikuar ndjeshëm në strukturën e përgjithshme të portofolit investues.


**FSKP alokoi 84.7 përqind të mjeteve në tregjet jashtë Kosovës, duke e rritur pjesëmarrjen e investimeve jashtë vendit me 5.1 pikë përqindje.** Brenda këtij portofoli, 96.7 përqind e mjeteve janë investuar në aksione, ndërsa pjesa e mbetur prej 3.3 përqind mbahet në para të gatshme për të ruajtur likuiditetin dhe fleksibilitetin. Në tregun e brendshëm, FSKP alokoi 15.3 përqind të mjeteve, kryesisht në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Në dhjetor 2024, këto investime shënuan një rënie vjetore prej 19.6 përqind, pas një rritje prej 24.6 përqind një vit më parë. Si rezultat, pesha e tyre në totalin e investimeve u zvogëlua, duke zbritur në 12.7 përqind nga 15.7 përqind në dhjetor 2023. Pjesa tjetër e mjeteve të mbajtura në vend, e përbërë nga paraja e gatshme dhe depozitat në banka komerciale, përfaqëson 2.7 përqind të portofolit.

**Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja deri në fund të vitit 2024 arriti në 315.8 milionë euro, duke reflektuar një ngadalësim të rritjes vjetore në 10.4 përqind nga 18.5 përqind një vit më parë (grafiku 42).** Dinamika e rritjes së ngadalësuar i atribuohet efektit të bazës së rritur në vitin paraprak, që u ndikua nga rritja e pagave të sektorit publik (Zbatimi i Ligjit për Zyrtarët Publikë), si dhe nga presionet për rritjen e pagave në sektorin privat për shkak të inflacionit të lartë.

**Kthimi bruto në investime arriti në 247.2 milionë euro deri në dhjetor 2024, një vlerë shumëfish më e lartë krahasuar me 87.7 milionë euro të realizuara në vitin paraprak.** Kontributin kryesor në këtë rritje e dha tremujori i parë, i nxitur nga rritja e çmimit të aksioneve në tregjet ndërkombëtare, si rezultat i pritjeve pozitive për ngadalësimin e rritjes së normave bazë të interesit nga bankat qendrore. Në tremujorin e dytë, kthimi u ul ndjeshëm krahasuar me tremujorin e parë dhe me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Tremujori i tretë shënoi një kthim bruto të konsiderueshëm prej 84.8 milionë euro, ndërsa në tremujorin e katërt kthimi nga investimet zbriti në 44.6 milionë euro. Megjithatë, kthimi në investime në TM4 mbeti më i lartë krahasuar me 40.1 milionë euro të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Çmimi i aksioneve të FKPK-së u rrit në 1.82 euro nga 1.67 euro për njësi duke pasqyruar një menaxhim të suksesshëm të mjeteve, me fokus në rritjen e vlerës së kursimeve të kontribuuesve.


FSKP-ja shënoi një rritje vjetore prej 51.4 përqind në kthimin bruto nga investimet në dhjetor 2024, duke arritur në **1.2 milionë euro**, (grafiku 43). Tremujori i parë dha kontributin më të madh në këtë rritje, duke përfaqësuar 41.9 përqind të totalit të kthimit, i ndjekur nga TM4 me 27.3 përqind. Në

Grafik 42. Performanca e FKPK-së



Burimi: FKPK.

Grafik 43. Performanca e FSKP-së



Burimi: FSKP.

tremujorin e katërt, kthimi nga investimet u rrit ndjeshëm në 337.2 mijë euro, nga 161.7 mijë euro në TM3. Megjithatë, ishte më i ulët krahasuar me TM4 të vitit 2023, kur arriti 403.7 mijë euro.

Çmimi i aksioneve të FSKP-se u rrit në 2.15 euro për njësi nga 1.96 për njësi një vit më parë.

Në fund të dhjetorit 2024, kontributet e arkëtuara nga FSKP-ja shënuan një ngadalësim të ndjeshëm të rritjes, në **0.7 përqind**, nga **9.6 përqind** një vit më parë, dhe arritën **0.67 milionë euro**.

#### 4.3. Sektori i sigurimeve

**Sektori i sigurimeve vazhdoi të rritet por me një ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, e mbështetur nga rritja e përshpejtuar e primeve të shkruara.**


Vlera e gjithsej aseteve arriti në 334.0 milionë euro deri në fund të dhjetorit 2024, duke shënuar një rritje vjetore prej **9.8 përqind**, më e ulët se **12.7 përqind e shënuar në dhjetor 2023** (grafiku 44). Në kuadër të aseteve, rritjen më të theksuar e shënuan depozitat e mbajtura në bankat komerciale, të cilat shënuan rritje vjetore prej 16.0 përqind. Si rezultat, pesha e tyre në totalin e aseteve u rrit në 48.9 përqind, krahasuar me 46.3 përqind një vit më parë. Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, si kategoria e dytë me peshën më të madhe, shënuan një rritje prej 3.7 përqind, megjithatë, pjesëmarrja e tyre në totalin e aseteve pësoi një rënie, duke zbritur në 15.8 përqind nga 16.7 përqind. Rezervat teknike të risiguresve gjithashtu shënuan rritje vjetore prej 16.0 përqind, duke e rritur pjesëmarrjen e tyre në totalin e aseteve në 14.9 përqind nga 14.1 përqind një vit më parë.

**Vlera e përgjithshme e primeve të shkruara shënoi rritje vjetore prej 14.7 përqind në dhjetor 2024, duke arritur në 168.1 milionë euro, krahasuar me një rritje prej 9.4 përqind në vitin e kaluar (grafiku 45). Sigurimet "jo-jetë" shënuan rritje vjetore prej 14.7 përqind. Ndërkohë, sigurimet "jetë", megjithëse me një pjesëmarrje të ulët prej 4.5 përqind në gjithsej primet, u rritën me normë vjetore prej 15.7 përqind.**


Brenda sigurimeve 'jo-jetë', rritja e primeve u ndikua kryesisht nga kategoria 'Përgjegjësia motorike ndaj palës së tretë', respektivisht 'MTPL e brendshme', e cila përfaqëson 55.5 përqind të tregut. Kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 7.7 përqind, por me një ngadalësim krahasuar me rritjen prej 9.7 përqind të vitit të kaluar. Ndërsa, 'Sigurimi i sëmundjeve', si kategoria e dytë më e madhe në sigurimet 'jo-jetë', me një pjesëmarrje prej 22.9 përqind, shënoi një rritje të përshpejtuar vjetore prej 28.3 përqind, nga vetëm 6.5 përqind një vit më parë.

Vlera e primeve të shkruara bruto në segmentin e sigurimeve të 'jetës' u ndikua kryesisht nga kategoria 'Jeta e Debitorit', e cila përbën 53.8 përqind të totalit të primeve në këtë segment. Kjo kategori shënoi një rritje të

Grafik 44. Asetet e sektorit të sigurimeve



Grafik 45. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



përsheptuar vjetore prej 28.0 përqind në vitin 2024, krahasuar me 4.9 përqind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sektori i sigurimeve 'jo-jetë' shënoi një rritje prej 33.0 përqind në numrin e policave të shitura, ku kontributin kryesor e dha kategoria '*Përgjegjësia Motorike ndaj palëve të treta*', e cila përfaqëson 61.1 përqind të totalit të policave të sigurimit 'jo-jetë'. Ndërkohë, sektori i sigurimeve '*Jetë*' shënoi një rritje prej 22.6 përqind në numrin e policave të shitura, e ndikuar kryesisht nga kategoria '*Jetë në Grup*', e cila dominoi me një pjesëmarrje prej 70.5 përqind në totalin e policave të sigurimit të jetës.

**Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve u rrit në 77.0 milionë euro nga 71.4 milionë euro, apo rritje prej 7.8 përqind, krahasuar me rritjen prej 11.1 përqind në vitin paraprak (grafiku 45).**

Në të njëjtën periudhë, numri i dëmeve të paguara u rrit për 23.5 përqind, dhe arriti në 226.6 mijë në dhjetor 2024. Rritja shumë më e lartë e numrit të dëmeve në raport me gjithsej vlerën e dëmeve sugjeron që sektori ka paguar më shumë dëme, por me një vlerë mesatare më të ulët për dëm.

Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve shënoi një rritje vjetore prej 5.7 përqind, duke arritur në 69.4 milionë euro në dhjetor 2024. Në të njëjtën periudhë, dëmet e paguara nga BKS-ja u rritën me 32.3 përqind, duke arritur në 7.6 milionë euro. Edhe pse dëmet e paguara nga BKS-ja përbënin vetëm 10.2 përqind të totalit të dëmeve, rritja e tyre pati ndikim në dinamikën e përgjithshme të tregut.

Kategoria kryesore që kontribuoi në rritjen e dëmeve të paguara ishte '*Përgjegjësia motorike ndaj palëve të treta*', e cila u rrit me 4.7 milionë euro dhe arriti në 45.2 milionë euro, kryesisht si rezultat i dëmeve nga policat kufitare dhe MTPL-të e brendshme. Ndërkohë, '*Sigurimi i sëmundjeve*', që përbën 25.4 përqind të totalit të dëmeve të paguara, shënoi një rritje prej 25.9 përqind, duke arritur në 19.2 milionë euro.

Si rezultat i rritjes më të lartë të primeve krahasuar me dëmet, raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të pranuar u ul në 45.8 përqind në dhjetor 2024, nga 48.8 përqind një vit më parë. Kjo tregon se sektori i sigurimeve po gjeneron më shumë të hyra në raport me dëmet e paguara, duke reflektuar një përmirësim në qëndrueshmërinë financiare.

Rritja e të hyrave, kryesisht nga primet neto të fituara, tejkaloi ritmin e rritjes së shpenzimeve dhe dëmeve të ndodhura, duke rritur fitimin neto të sektorit me 43.0 përqind, nga 10.7 milionë euro në 15.3 milionë euro.

Të hyrat e sektorit, të mbështetura kryesisht nga primet e shkruara, u rritën me 17.3 përqind, duke arritur në 147.9 milionë euro, ndërkohë shpenzimet u zgjeruan me një ritëm më të ngadalësuar prej 15.2 përqind, duke arritur në 132.5 milionë euro. Brenda shpenzimeve, dëmet e ndodhura u rritën me 7.2 përqind, duke arritur në 77.0 milionë euro, ndërkohë shpenzimet operationale, përfshirë ato për personelin dhe administratën, u rritën me 21.4 përqind, duke arritur në 52.3 milionë euro. Rritja e profitit neto u reflektua në ngritjen e tregueseve të profitabilitet. Kthimi mesatar në asete u rrit në 5.4 përqind nga 4.4 përqind dhe kthimi mesatar në kapital u rrit në 18.5 përqind nga 14.8 përqind në dhjetor 2023.

Kapitali në raport me marginën e solvencës për siguresit '*jo-jetë*' shënoi rënie vjetore në 132.9 përqind nga 160.6 përqind. Kurse, kapitali në raport me marginën e solvencës për siguresit '*Jetë*' shënoi rritje vjetore të lehtë në 718.3 përqind nga 716.0 përqind një vit më parë. Kapitali në raport me fondin garantues për siguresit '*jo-jetë*' shënoi rënie në 147.9 përqind nga 158.3 përqind në 2023. Ndërsa, kapitali në raport me fondin garantues për siguresit '*jetë*' është rritur në 175.7 përqind nga 143.6 përqind në vitin 2023. Në fund të vitit, sektori i sigurimeve '*Jo-Jetë*' kishte mbulueshmërinë me provizione teknike në nivelin 111.8 përqind, lehtësisht rritje nga 108.6 përqind në dhjetor 2023. Ndërsa, sektori i sigurimeve '*Jetë*' zbriti lehtësisht mbulueshmërinë me provizione në 114.3 përqind nga 115.0 përqind një vit më parë.


Niveli i likuiditetit të sektorit shënoi rritje të lehtë në krahasim me vitin paraprak. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave u rrit në 99.0 përqind nga 97.5 përqind sa ishte në fund të dhjetorit 2023. Ndërkohë, raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u rrit në 88 përqind në krahasim me vitin paraprak prej 85.6 përqind.

#### 4.4. Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar vazhdoi të rritet, por me një ritëm më të ngadalësuar, i nxitur kryesisht nga zgjerimi i kreditimit përderisa kontributi nga lizingjet ishte më i kufizuar. Në dhjetor 2024, asetet e sektorit arritën në 650.7 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 20.5 përqind, e cila është më e ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 34.8 përqind në dhjetor 2023. Të gjitha kategoritë e aseteve shënuan rritje, me kreditë që vazhdojnë të përbëjnë pjesën më të madhe të portofolit të sektorit, të ndjekura nga lizingjet dhe bilancet e mbajtura në bankat komerciale (grafiku 46). Nga ana e financimit, huamarrjet nga sektori i jashtëm – burimi kryesor i financimit për këtë sektor – vijuan rritjen, por me një ritëm më të ngadalësuar, duke u rritur me 19.3 përqind në dhjetor 2024, krahasuar me 31.9 përqind një vit më parë.


**Stoku i kredive të sektorit mikrofinanciar arriti në 449.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 24.6 përqind, lehtësisht të ngadalësuar nga 25.9 përqind në vitin paraprak.** Rritja e vlerës së kreditimit reflektohet nga kërkesa për kredi nga të dy segmentet: ekonomitë familjare dhe korporatat jo-financiare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare arriti në 264.7 milionë euro në dhjetor 2024, duke shënuar rritje vjetore prej 20.1 përqind (21.1 përqind në të njëjtën periudhë të vitit 2023). Ndërsa, kreditë ndaj korporatave jo-financiare arritën në 184.6 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 31.7 përqind (34.2 përqind në dhjetor 2023). Pjesëmarrja e kredive të korporatave financiare ndaj totalit është rritur në 41.1 përqind nga 38.9 përqind, ndërsa pjesëmarrja e kredive të ekonomive familjare është ulur në 58.9 përqind nga 61.1 përqind. Kjo tregon një zhvendosje të lehtë në strukturën e kredive, ku korporatat financiare po marrin një pjesë më të madhe të kredive totale (grafiku 47).

Grafik 46. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 47. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jo-financiare



Burimi: BQK.


Grafik 48. Vlera e kredive ndaj korporatave jo-financiare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.


Kreditimi ndaj korporatave jo-financiare sipas sektorëve të ekonomisë ka vazhduar trendin e viteve të kaluara, duke shënuar rritje në të gjithë sektorët. Sektori i bujqësisë mbajti pjesëmarrjen më të madhe në totalin e kredive për korporatat jo-financiare, me 24.4 përqind, duke shënuar një rritje vjetore prej 28.6 përqind nga 30.0 përqind. Sektori i tregtisë, me pjesëmarrje prej 11.6 përqind të gjithsej kredive për korporatat jo financiare, shënoi rritjen më të madhe vjetore prej 39.1 përqind (39.0 përqind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar) (grafiku 48). Në aspekt të kontributit të rritjes së gjithsej kreditimit të KJF-ve, sektori i bujqësisë kishte kontribut më të lartë prej 7.1 përqind si rezultat i peshës më të lartë, ndërsa tregtia me 4.3 përqind (grafiku 49).

Grafik 49. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: BQK.

Grafik 50. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Lizingu, si kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha në asetet e sektorit mikrofinanciar, ka ulur pjesëmarrjen e tij në 15.8 përqind nga 17.9 përqind. Në fund të dhjetorit 2024, vlera e tij arriti në 103.1 milionë euro, duke shënuar një ngadalësim të konsiderueshëm të rritjes vjetore në 6.9 përqind nga 30.8 përqind në dhjetor 2023. Lizingu për korporatat jo-financiare zë një peshë të konsiderueshme prej 73.1 përqind të totalit të lizingut. Vlera e tij u rrit në 75.3 milionë euro në dhjetor 2024, megjithatë, norma e rritjes shënoi një ngadalësim të ndjeshëm, duke zbritur në 12.5 përqind nga 47.9 përqind në dhjetor 2023, kur lizingjet për këtë segment u rritën konsiderueshëm (grafiku 50).


Në anën tjetër, lizingu për ekonomitë familjare, që përbën 26.9 përqind të totalit të lizingut, arriti vlerën në 27.8 milionë euro, duke shënuar një rënie vjetore prej 5.9 përqind, në kontrast me rritjen prej 3.5 përqind të shënuar një vit më parë.

Grafik 51. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Grafik 52. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Norma mesatare e interesit në kredinë e lëshuar nga sektori mikrofinanciar arriti në 18.7 përqind, duke u rritur me 0.1 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (grafiku 51). Megjithatë, krahasuar me tremujorin e kaluar, norma e interesit pati një tendencë rënës, duke zbritur për 0.5 pikë përqindje.

Norma më të favorshme të interesit kishin korporatat jo financiare, prej 15.6 përqind, duke shënuar një rënie marginale vjetore, për 0.3 pikë përqindje. Në nivel sektorial, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë për shërbime prej 15.3 përqind, të cilat shënuan rritje vjetore prej 0.2 pikë përqindje. Ndërkohë, sektori i bujqësisë dhe ai i industrisë përjetuan një ulje të normave të interesit përkatësisht me 0.7 dhe 1.6 pikë përqindje (grafiku 52).


Nga ana tjetër, ekonomitë familjare kishin norma më të larta të interesit në raport me KJF-të, përkatësisht normë mesatare prej 21.7 përqind, duke u rritur për 0.6 pikë përqindje në dhjetor 2024 krahasuar me vitin paraprak. Norma e interesit për kreditë konsumuese u rrit për 0.5 pikë përqindje në dhjetor 2024 dhe norma e interesit për kreditë hipotekare u rrit për 1.3 pikë përqindje në dhjetor 2024.

**Profiti neto i sektorit mikrofinanciar arriti në 20.3 milionë euro, duke shënuar një rritje vjetore të përsheptuar prej 12.5 përqind krahasuar me 6.4 përqind një vit më parë, e ndikuar nga rritja më e lartë e vlerës së të hyrave krahasuar me atë të shpenzimeve.**

Të hyrat e sektorit u rritën për 19.9 milionë euro, ose 28.2 përqind krahasuar me vitin paraprak, kur rritja ishte 26.1 përqind. Rritja e të hyrave u mbështet kryesisht nga rritja e të hyrave nga interesi, të cilat u rritën me 23.1 përqind (22.2 përqind në vitin e kaluar). Po ashtu, të hyrat nga jo-interesi shënuan rritje vjetore prej 62.1 përqind (60.7 përqind një vit më parë), duke arritur në 14.9 milionë euro.


Shpenzimet u rritën me 33.6 përqind (rritje prej 34.7 përqind një vit më parë), të ndikuara kryesisht nga rritja e shpenzimeve të jo-interesit, të cilat u rritën me 25.3 përqind (20.5 përqind një vit më parë), duke arritur në 34.7 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për personelin

**Grafik 53. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar**




Burimi: BQK.

**Grafik 54. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore (IMF/IFJB)**



Burimi: BQK.

**Grafik 55. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.**



Burimi: BQK.


dhe ato administrative u rritën ndjeshëm me 20.7 përqind, krahasuar me 11.6 përqind vitin e kaluar. Shpenzimet e interesit, në vlerë prej 23.1 milionë euro, kontribuan gjithashtu në këtë rritje, duke u rritur me 63.0 përqind, krahasuar me rritjen më të lartë prej 69.2 përqind të shënuar një vit më parë. Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave është rritur me 3.1 pikë përqindje dhe arriti në 77.6 përqind në dhjetor 2024, duke reflektuar rritjen relative më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat. Indikatorët kryesorë të profitabilitetit shënuan rënie në dhjetor 2024, me kthimin në mesataren e aseteve duke rënë me 0.6 pikë përqindje dhe kthimin në mesataren e kapitalit duke rënë me 1.5 pikë përqindje. **Raporti i kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive të institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jo-bankare në fund të dhjetorit 2024 zbriti në 1.6 përqind nga 1.8 përqind një vit më parë.** Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione vazhdon të jetë e qëndrueshme, ndonëse zbriti lehtësisht në 148.4 përqind nga 149.7 përqind një vit më parë (grafiku 54). Raporti i kredive jo-performuese vazhdon të jetë më i lartë për IFJB-të kundrejt IMF-ve. Për institucionet mikrofinanciare, ky raport është rritur në 1.6 përqind nga 1.5 përqind, ndërsa për IFJB-të ka zbritur në 1.9 përqind nga 2.8 përqind (grafiku 55).

#### 4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, borxhi i emetuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës u dyfishua krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023, duke arritur një vlerë totale prej 60.0 milionë euro (grafiku 56). Sidoqoftë, raporti i gjithsej borxhit të brendshëm ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV) zbriti në 9.12 përqind në fund të vitit 2024 nga 10.02 përqind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo si rezultat i shkallës më të lartë të rritjes së BPV-së në raport me borxhin e mbetur, i cili shënoi rënie si rezultat i shkallës më të lartë të maturimeve në raport me rritjen e emetimeve reja.


Kërkesa për investime në letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria ka tejkaluar për 2 herë ofertën e disponueshme për këto instrumente në këtë tremujor (grafiku 57). Ndërsa, në fund të dhjetorit 2024, stoku i borxhit të brendshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në formë të letrave me vlerë, zbriti në 962.2 nga 970.2 në dhjetor 2023.

Grafik 56. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 57. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 58. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Mbajtësit e letrave me vlerë qeveritare vazhdojnë të udhëhiqen nga fondet pensionale që përbëjnë 45 përqind të stokut të borxhit qeveritar, pasuar nga bankat komerciale me 24 përqind, institucionet publike me 22 përqind dhe kompanitë e sigurimit që përbëjnë 5 përqind të stokut të borxhit. Struktura e letrave me vlerë dominohet nga obligacionet qeveritare me periudha maturimi prej 5 vitesh, pasuar nga ato me periudha maturimi prej 3 dhe 2 vitesh. Bonot e thesarit, që përbëjnë 7.4 përqind të totalit dhe kanë një maturitet maksimal prej 364 ditësh, u emetuan këtë vit në vlerë prej 20 milionë euro, pas një pauze trevjeçare (grafiku 58).

### Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 49, TM4 2024, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

### Referencat:

#### **BQK:**

- a) Buletini Mujor Statistikor: Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (bqk-kos.org)

#### **ASK:**

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

#### **Të tjera:**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: Ballina | FKPK (trusti.org)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntë mujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntë mujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

**Euribor:** Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

**ECB (BQE):** Economic Bulletin Research & Publications (europa.eu); Key ECB interest rates (europa.eu)

**FAO:** Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations (fao.org)

**IMF (FMN):** International Monetary Fund (IMF)

**World Economic Outlook:** World Economic Outlook (imf.org)

**World Bank:** Commodity Markets: Commodity Markets (www.worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)